



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 6037

NR. VENDIMI 5245



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr. Regj. Them.: 11363/6037

Nr. Vendimi: 5245

Datë Regjistrimi: 04.09.2020

Data e Vendimit:

21.07.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Alma KODRALIU - GJYQTARE

asistuar nga sekretare gjyqësore Gencjana Dada, sot, më datë 21.07.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen gjyqësore me Nr. Regj. 11363/6037, me palë ndërgjyqëse, objekt dhe bazë ligjore si më poshtë vijon:

PADITËS: Shoqëria ***, përfaqësuar prej administratorit te saj z. ***, me seli te ndodhur në ***.

I PADITUR: Shoqëria ***, përfaqësuar nga administrator saj, z. ***, me seli të ndodhur në adresën ***

PERSON I TRETË: ***, me adresë: ***

***, me adresë: ***.

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur, shoqëria *** që të pushojë cenimin e te drejtave te pronesise industriale ndaj pales paditese lidhur tregetimin e produktit birre ***, sipas te drejtave qe burojne nga kontrata e licenses e rregjitruar ne regjistrin e markave sipas vendimit te dates *** te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.

Ndalimin e pales se paditur qe te tregetoje ne territorin shqipetar, produktin birre, qe mban logon ***, mallra dhe sherbimet te rregjistruara per klasat 32 dhe 42 sipas

klasifikimit të Nices, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare pa autorizimin e pales paditëse, shoqërisë *** në cilësinë e distributorit ekskluziv të këtij produkti. Ndalimin e veprimeve të konkurrencës së pandershme prej pales së paditur dhe mosperseritja me e tyre në të ardhmen.

Detyrimi i pales së paditur të paguaje të gjithë shpenzimet gjyqësore, avokatote si dhe ato doganore (magazininin doganor) për efekt të ndjekjes së procedurës së pezullimit të klirimit të mallit të pales së paditur me 18.08.2020 në zbatim të dispozitave.

Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke mos lejuar palën e paditur, shoqëria *** që të tregetojë apo importojë produktin birre *** dhe moslejimin e këtij produkti të hyjë në qarkullim deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes në themel.

BAZA LIGJORE: Neni 1, 163, 170 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" neni 83/1/a, 87 i ligjit 7819, datë 27.04.1994, Vendim nr. 1090, datë 28.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar: Pika 5, e nenit 2, neni 7,19, Neni 202, 205, 206 Kodi i Procedurës Civile.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet përfundimtare të përfaqësuesit të palës paditëse, Av. ***, e cila kërkoi pranimin e padisë sipas objektit të saj, në mungesë të palës së paditur *** si dhe në mungesë të personave të tretë *** dhe ***,

VËREN:

RRETHANAT E FAKTIT

Paditësi, shoqëria *** është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Nr. Nuis ***, me objekt veprimtarie, ndër të tjera, import, eksport dhe tregëtim të artikujve të ndryshëm, pijeve alkoolike etj. Nga ana tjetër, i Padituri, shoqëria *** është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Nr. Nuis ***, me objekt veprimtarie, ndër të tjera, import, eksport dhe tregëtim të artikujve të ndryshëm, pijeve alkoolike etj.

*** është titullare e kontratës së licencës të lidhur me shoqërinë ***, kontratë kjo e regjistruar në regjistrin e markave në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Nga përmbajtja e Njoftimit për Regjistrim të Kontratës së Licencës me Nr. *** prot., datë *** (që ndryshon Njoftimin e datës ***), rezulton se kontrata e licencës midis shoqërisë *** dhe shoqërisë *** i referohet markës me emërtimin *** me nr. regjistrimi ndërkombëtar ***, me Licensues shoqëria *** dhe të Licensuar ekskluziv ***. Kontrata e Licencës është ekskluzive dhe pa afat dhe është dhënë "Për të gjitha mallrat dhe shërbimet e regjistruara për klasat 32 dhe 42 sipas Klasifikimit të Nicës".

Shoqëria ***, në cilësinë e të licensuarit ekskluziv ka aplikuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për mbrojtjen e markës tregtare ***, aplikim i cili është

miratuar dhe i është komunikuar paditësit me shkresën nr. ***prot., datë ***.

I padituri shoqëria *** ka kryer procedurat doganore për importimin e një sasive prej 7260 litra birrë e markës ***, nga shoqëria ***. Clirimi i këtij malli është pezulluar nga Dega e Doganës Tiranë, pasi është dyshuar se ky mall cënon të drejtat të pronësisë intelektuale të paditësit Shoqëria ***.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i ka komunikuar paditësit nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë *** me lëndë "Njoftim për pezullimin e clirimit të mallrave të dyshuara si cënuese së të drejtave të pronësisë intelektuale" se në datën 18.08.2020, autoritetet doganore kanë pezulluar clirimin e mallrave të llojit "birrë", në sasinë 7260 Litra, si të dyshuara si cënuese së markës tregtare ***. Po ashtu, nëpërmjet këtij njoftimi i është kërkuar paditësit, që në përputhje me nenin 384 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, që brenda 10 ditëve pune, të japë konfirmim me shkrim lidhur me faktin nëse pretendon, sipas bindjes së tij, se janë shkelur të drejtat e pronësisë intelektuale si dhe të japë pëlqimin për shkatërrimin e këtyre mallrave.

Paditësi Shoqëria ***, nëpërmjet shkresës nr. ***prot., datë ***i ka komunikuar personit të tretë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave se jemi përpara një cënimi të të drejtave të pronësisë industriale, ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave të bllokuara si dhe ka kërkuar informacionin e nevojshëm me qëllim fillimin e një procesi gjyqësor kundër subjektit importues të mallrave të bllokuara nga autoritetet doganore si të dyshuara si cënuese së markës tregtare "****". Informacioni i kërkuar (shoqëria importuese, vendi i origjinës etj) i është vënë në dispozicion paditësit me shkresën nr. *** prot., datë *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ndërkohë, duke mos qenë dakord me veprimet administrative të Degës së Doganës Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pala e paditur shoqëria *** ka paraqitur fillimisht kërkesë për sigurim padie në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kjo e fundit, me Vendimin (nr. *** regj. Them) datë *** ka vendosur marrjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ për pezullimin e clirimit të mallit birrë "****". Më tej, shoqëria *** ka paraqitur përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt: "1. Deklarimin e paligjshëm të aktit administrativ me lende "Njoftim për regjistrimin e kontrates së Licenses" me nr ***Prot date ***. 2. Deklarimin e paligjshëm të aktit administrativ e konkretisht vendimi me nr *** date *** e marrë nga Drejtoria për Mbrojtjen Intelektuale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tirane. 3. Deklarimin e paligjshëm të aktit administrativ me nr *** prot date *** me lende " Njoftim për pezullimin dhe /ose ndalim të clirimit të mallrave të dyshuara që shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale për të cilat është miratuar një aplikim për veprim". 4. Shfuqizimin e akteve administrative e konkretisht: aktit administrativ me lende Njoftim për regjistrimin e kontrates së Licenses date *** Prot date *** e marrë nga Drejtoria për Mbrojtjen Intelektuale pranë Drejtorisë së

Pergjithshme te Doganave Tirane.

vendimit me nr * date *** e marre nga Drejtoria per Mbrojtjen Intelktuale prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Tirane."**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. *, datë ***, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë padisë administrative si të pambështetur në ligj dhe në prova. Heqjen e masës së sigurimit të padisë, të urdhëruar, sipas vendimit të ndërmjetëm datë *** të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë, në zbatim të nenit 40 të ligjit me Nr.49/2012, i ndryshuar.", vendim i cili ka marrë formë të prerë si i paankimuar më datë ***.**

Nga ana tjetër, shoqëria *, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, i është drejtuar me padinë objekt gjykimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

PRETENDIMET E PALËVE

Pala paditëse, në mënyrë të përmbledhur, parashtroi këto pretendime:

Paditësi Shoqëria * ka hyre ne marredhenie bashkepunimi nepermjet kontrates se shperndarjes lidhur ndermjet saj dhe shoqerise ***. Referuar percaktimeve te kesaj kontrate, qellimit dhe parashikimeve te gjendura ne te, rezulton se shoqeria" *** ne cilesine e shperndaesit ekskluziv te produktit, birrre *** ne territorin shqipetar, marke e rregjistruar prej pales prodhuese ***, ka detyrim te saj qe ne rastet kur merr dijeni per ndonje shkelje, imitim ose perdorim te paligjshem markave ne ndonje menyre nga nje pale tjetere e trete, duhet te beje perpjekje maksimale per te mbeshtetur *** ne mbrojtjen e te drejtave te veta ne territor, (shih neni 8 pika 5 e kontrate se shperndarjes).**

Duke qene se dispononte nje marreveshje te tille distribucioni ekskluziviteti prej pronarit te markes, ne referim te kushteve te percaktuara ne Ligjin nr. 9947, dt.07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", paditësi i është drejtuar nepermjet aplikimit sipas formatit te kerkuar nga ky ligj Drejtorise se Pronesise Industriale fillimisht qe te rregjistroje kontraten e licenses nga ku ka rezultuar se kjo e fundit nepermjet vendimarjes se saj qe mban daten *, te kete regjistruar ne regjistrin e markave kontraten e licenses per marken "****" me te dhenat respektive gjendur ne menyre te detajuar ne permbajtjen e ketij akti ne favor te pales paditese e cila ne kete akt merr emertimin "I licensuari" duke referuar ketu specifikisht llojin ekskluzive te kesaj kontrate license dhe listen e mallrave konkret qe permban kjo kontrate license te cilat jane "te gjitha mallrat dhe sherbimet e rregjistruara per klasat 32 dhe 42 sipas klasifikimit te Nices".**

Me pas, pala paditese ka aplikuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ne formen e kerkuar nga ligji duke kerkuar qe kjo e fundit te miratoje ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me mallrat që dyshohet se shkelin kete te drejte të pronësisë

intelektuale lidhur me objektin qe perfaqesonte kontrata e licenses per te cilen pala paditese tanime kishte te rregjistruar ne rregjistrin e markave. Ka rezultuar se ky aplikim i pales paditese eshte miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, fakt i cili evidentohet qarte ne shkresen me nr ***prot date ***duke u cilesuar tanime paditesi si "Mbajtës i vendimit" (emertim i cili nënkupton një person ndaj të cilit është dhënë vendimi në bazë të aplikimit).

Ka rezultuar se ne dijeni te pales paditese, shoqerise ***nga Drejtoria per Mbrojtjen Pronesise Industriale prane Drejtorise se e Pergjithshme te Doganave eshte sjelle shkresa me nr *** date ***e emertuar:-" Njoftim mbi pezullimin e çlirimit te mallrave te dyshuara si cenuese te se drejtave te pronesise industriale", me anen e se ciles eshte referuar fakti i bllokimit te nje sasie malli i llojit birre, prej-7260 litra, bllokim i mundesuar me date 18.08.2020.

Ky bllokim i kesaj sasie eshte bere ne kuadrin e dyshimit te cenimit te se drejtes se markes tregtare "****", per te cilen sikunder cituam dhe me lart eshte miratuar nje aplikim per veprim nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave me anen e vendimit me nr *** prot date *** ne favor te shoqerise sone si i licensuar ekskluziv.

Lidhur me c'ka referohej ne kete shkrese, mbeshtetur ne percaktimet e gjendura ne VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014,Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", seksionin 4, (Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallrave), Neni 378-" Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallrave pas miratimit të aplikimit "(Nenet 10, 27, 125, 131 të Kodit), kemi kerkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave qe te na informonin (1) lidhur me shoqerine qe mbart cilesine e deklaruesit te mallit te bllokuar, (2) te dhenat, emrat dhe adresat e marrësit të ngarkesës, (3) te dhenat, emrat dhe adresat e dërguesit, (4) procedurat doganore te ndjekura ne rastin konkret dhe origjinën, (5) prejardhjen dhe destinacionin e mallrave, për të cilat është pezulluar çlirimi ose që janë ndaluar.

Ne referim te nenit 382 pika 1 germa(a) te VKM-se nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", Përdorimi i lejuar i një informacioni të caktuar nga mbajtësi i vendimit, Neni 20 i Kodit, "Për të filluar një procedim gjyqësor, që përcakton nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, si dhe gjatë kohëzgjatjes së procedimit", pala paditese ka kerkuar po ashtu qe ti vihet ne dispozicion tere informacioni i sipercituar lidhur me mallin e dyshuar si cenes i se drejtave te pronesise industriale i pezulluar per clirim te dates 18.08.2020.

Duke rene ne dijeni te te dhenave te sipercituara, pala paditese nepermjet kesaj kerkese padie permyll kete procedure te nisur nga personi trete, Drejtoria Per Mbrojtjen e pronesise Industriale dhe cmon se ndodhet peprara kushteve te cenimit te nje te drejte te saj prej veprimeve te mundesuar prej pales se paditur.

Ndodhur ne te tille rrethana, mbeshtetur ne bazën ligjore të referuar në padi, pala paditese cmon se legjitimon veten ne paraqitjen e kesaj kerkese padie, duke shtuar ketu faktin se pala e paditur nepermjet veprimeve te saj ka cenuar nje te drejte te mbrojtur sipas objektit te kontrates se licensimit, e konkretisht duke tregetuar nepermjet importimit te produktit birre *, ne territorin shqiptar, veprim i cili eshte konstatuar me te drejte prej personit te trete ne kete kerkese padi e cila me pas ka rezultuar qe te kete filluar proceduren e percaktuar ne keto parashikime ligjore.**

Pala e paditur nepermjet procedures se filluar nga personi trete jo vetem qe nuk ka reflektuar per te pasur nje leje prej pales se paditur lidhur me tregetimin e ketij produkti ne territorin shqiptar, e drejte ekskluzive qe mbartet vetem prej pales paditese dhe e dhene prej vete mbajtesit te markes, prodhuesit *, por ka insistuar ne parregullsine e veprimeve te saj duke percjelle qendrimin e saj jo miratues per proceduren e konstatimit dhe verifikimit ne kuadrin e dyshimit te cenimit te se drejtes se markes tregtare “***” te nisur nga personi trete ne kete kerkese padi dhe me pas duke kerkuar qe malli i pezulluar per clirim me date *** prej personit te trete te behej nje send ne qarkullim ne menyre haptazi sfiduese me dispozitat urdheruese te ligjit.**

Sjellim ne vemendjen e kesaj gjykate se, pala paditese (i) ka të drejtën ekskluzive për importimin e tregtimin e këtyre mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë ; (ii) pala e paditur shoqëria * me veprimet e importit dhe tregtimit të mallrave të sipër përmendura, të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore nga regjistrimi i kontrates se licenses ne emer te pales paditese,e ka cenuar në të drejtat te mbrojtura pronësisë, duke shkaktuar dëm konkret, ndaj per rrjedhoje fillimisht kerkohet nderprerja e ketij cenimi dhe ne vazhdim dhe detyrimi i palës së paditur: (i) t'i shpërblejë dëmin e shkaktuar në shumën qe do konkretizohet nepermjet marrjes se proves me ekspert gjate gjykimit, (ii) të mos tregtojë në të ardhmen,mallin e llojit birre të markaes tregtare “***”.**

Nisur nga rasti ne fjale, cmojme qe pala e paditur duke importuar dhe tregtuar mallrat e sipërpërmendura, lloji birre *, të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore nga regjistrimi i markave të tyre ka cenuar të drejtat te mbrojtura me ligj.**

Per sa me lart, ne mbeshtetje te provave qe shoqerojne kete kerkese padi dhe referimeve te gjendura ne te do ti kerkonim gjykatës qe te pranoje kerkese padine lidhur me themelin e kerkimit.

Pala e paditur, në mënyrë të përmbledhur parashtrroi këto pretendime:

Pika e pare e objektit te padise konsiston ne Detyrimin e pales se paditur, shoqeria *, qe te pushoje cenimin e te drejtave te pronesise industriale ndaj pales paditese lidhur me tregtimin e produktit birre "****" sipas te drejtave qe burojne nga kontrata e licences e regjistruar ne regjistrin e markave sipas vendimit te dates ***te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Atehere ne kete gjykim pala paditese duhet te provoje (qe te kete legjitimetet aktiv): A) Qe eshte zoteruese e ligjshme e nje te drejte te**

njohur me ligj; B) Qe kjo e drejte te na detyroje ne si pale e paditur.

Fillimisht, i theksojme gjykates qe Shoqeria *** importon produkte të ndryshme dhe asnjëherë nuk ka patur pretendime nga subjektet distributorë zyrtarë të produkteve që importon. Ndër të tjera, Shoqëria *** importon dhe tregeton birre "****" te prodhuar nga fabrika meme ne *** dhe nga ana e distributorit zyrtar te saj ne Shqiperi nuk eshte paraqitur asnje pretendim. Po keshtu dhe lidhur me disa pije te tjera. Shoqëria jonë ka një kontratë furnizimi me shoqërinë *** me qender ne *** "****", shoqëri kjo e cila eshte nje nga kompanite logjistike e shperndarjeje te afro 4500 produkteve dhe rezulton nga me te medhate ne bote me nje shtrirje te verimtarise se saj ne te gjithë boten. Ne kemi dhe nje kontrate furnizimi me te ku jane percaktuar te drejtat dhe detyrimet perkatese. Te gjithe furnizimet e saj kane te shoqeruar mallin me certificate euro 1 qe provon jo vetem cilesine e mallit (sipas standarteve te BE-se) por edhe autenticitetin dhe origjinalitetin e tij. Mes produkteve te shumta shoqeria jone importon dhe tregeton birren e llojit "****".

Pala paditese pretendon se per importimin dhe tregetimin e ketij lloj malli: A) ka nje kontrate ekskluzive B) e ka rregjistruar ate ne Drejtorine e Patentave dhe Markave ne perputhje me ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale". Ne si pale e paditur kemi ngritur nje kerkesepadi para Gjykates Administrative me objekt: - Deklarimin e paligjshem te aktit administrativ me lende "Njoftim per regjistrimin e Kontrates se Licences" me Nr. ***Prot. Date ***. - Deklarimin e paligjshem te aktit administrativ ***date ***. Deklarimin e paligjshem te aktit administrativ me nr ***Prot. Date ***me lende "Njoftim per pezullimin dhe ose ndalim te clirimit te mallrave te dyshuara qe shkelin nje te drejte te pronesise intelektuale per te cilat eshte miratuar nje aplikim per veprim".-Marrjen e mases se sigurimit. Ne kemi pretendime lidhur me: a) ekzistencen e nje kontrate furnizimi me karakter ekskluziv midis kompanise gjermane "**** *** dhe shoqerise ***. b) menyren e rregjstrimit te kesaj kontrate ne Drejtorine e Patentave, pasi ka dyshime te bazuara ne prova se nuk jane repektuar rregullat e percaktuara ne ligjin Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale". Nese provohet padia jone ne Gjykaten Adminitrative bie menjehere legjitimiteti aktiv i paditesit.

Pala paditese as me kerkesepadine nuk ka depozituar ne gjykate dy kontratat e lidhura midis asaj dhe shoqerise gjermane "**** *** pasi jane bere dy rregjistrime ne Drejtorine e Markave dhe Patentave ne rrethin kohor te 15 diteve njera qe mban daten 25.06.2020 e cila flet per rregjistrim te nje kontrate me karakter joekskluziv e qe nuk permendet nga paditesi dhe te nje rregjistrimi te nje kontrate me karakter ekskluziv me date 09/07.2020 (Nuk na eshte vene ne dispozicion) cka ve ne dyshim vlefshmeri e kesaj te fundit. Prandaj i kerkojme gjykates te detyroje palen paditese te paraqese ne gjykim te dy kontratat e licensimit midis asaj dhe shoqerise gjermane ***.

Edhe ne rast se jemi perpara nje kontrate te pafalsifikuar midis kompanise gjermane ***dhe pales paditese Shoqeria *** dhe edhe nese ajo eshte rregjistruar ne perputhje

me ligjin ne Drejtorine e Patentave dhe Markave prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave perseri pala paditese nuk ka legjitimim aktiv.

Kontrata midis shoqerise gjermane dhe Shoqerise *** ne thelb eshte nje kontrate furnizimi. Ne nenin 690 te Kodit Civil sanksionohet se: "Kontrata lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj". Pra kontrata e furnizimit (qofte dhe me karakter ekskluziv) per birren e llojit ***, nuk ka efekt per ne si pale e paditur. Kjo kontrate detyron vetem palet e saj. Kjo do te thote qe distributori shqiptar eshte I mbrojtur nga konkurenca prej ndonje shoqerie tregtare me aktivitet ne territorin ne Republiken e Shqiperise e cila nuk mund te furnizohet drejtpersedrejt nga shoqeria gjermane ***. Per me teper edhe nese ne do te furnizoheshim nga kjo shoqeri do te ishte nje marredhenie kontraktore vetem midis pales paditese dhe shoqerise gjermane.

Pala paditese (nese kontrata me karakter ekskluziv eshte e vlefshme dhe e rregjistruara ne perputhje me ligjin) ka te drejten dhe detyrimin te mbroje marken "****" nga importimi dhe tregtimi i mallrave te ngjashme pirate apo te falsifikuara. Sic u theksua me lart malli yne eshte i shoqeruar me certificate euro 1 dhe i eshte nenshtuar rregullisht analizave te mbikqyruara nga AKU ne laboratoret e certifikuara per kete qellim (pra nuk behet fjale per mallra pirate apo te falsifikuara).

Pala paditese kerkon te sundoje tregun e vetme cka perben dhe nje shkelje te ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Keshtu ne nenin 4 qe ben fjale per marreveshjet e ndaluara sanksionohet se:

"1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

- a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;"

Ne rastin konkret kontrata e supozuar prej paditesit ka keto efekte jo vetem ndaj shoqerise sone por edhe ndaj shoqerive te tjera qe importojne dhe tregetojne birren e tipit ***.

Pala paditese ne kerkesepadine e paraqitur prej saj ngaterron pronarin e markes qe ne rastin tone eshte shoqeria gjermane *** dhe qe eshte licensuesi me te licensuarin (nese kontrata mes tyre eshte e vlefshme) qe ne rastin tone eshte pala paditese. Keshtu vete paditesi ne kerkesepadi thekson se: ne kontraten e saj te licensimit, (te cilen cuditerisht nuk ia ka paraqitur gjykates, pa te cilen paditesi as nuk legjitimohet per ngritjen e padise), ka detyrimin te saj qe ne rastet kur merr dijani per ndonje shkelje, imitim ose perdorim te paligjshem te markes ne ndonje menyre nga ndonje pale e tjetere e trete duhet te beje perpjekje maksimale per mbrojtjen e te drejtave te veta ne territor (neni 8 pika 5 e kontrates se shperndarjes).

Kjo kerkesepadi ka mungese te theksuar legjitimiteti aktiv dhe pasiv sepse, se pari, sipas kesaj kontrate shoqeria gjermane nuk i ka dhene te drejten eksplicite pales paditese qe te ngreje padi per te mbrojtur te drejtat e pronarit te markes qe eshte shoqeria gjermane *. Se dyti, malli i importuar nga shoqeria jone e tipit birre *** eshte importuar duke paguar te gjithe detyrimet e importit, taksat e tatimet perkatese, duke iu nenshtruar analizave laboratorike dhe tregtohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Se treti, ne nuk tregetojme mall imitim (I falsifikuar apo pirat) por *** original te prodhuar shoqeria gjermane *** (gje qe nuk e kundershton as vete paditesi) e cila ia ka shitur kompanise hollandeze me te cilen ne kemi kontrate shperndarjeje. Kush i njeh ekstermitetet e nje certificate euro 1 te mallit e di shume mire qe nje certificate e tille nuk leshohet per mallrat e falsifikuara apo pirate apo per mallra, zoteruesi i te cilave nuk ka tager per disponimin e tyre. Nje mall i certifikuar me certificate euro 1 tregon jo vetem origjinen e tij europiane dhe nuk sherben vetem per te percaktuar tarifimin doganor sic e kuptojne doganieret idjote, por tregon ne rradhe te pare qe malli eshte konform standarteve te Bashkimit Europian dhe se malli I certifikuar eshte original dhe autentik (per kete shih rubrikat e nje certificate euro 1).**

Pala paditese permend nenit 163 te Ligjit Nr. 9947, datë 7.7.2008 "Per Pronesine Industriale" ku percaktohet gjithë te drejtat e te licensuarit. Ne kreun XXIV Ligji Nr. 9947, datë 7.7.2008 "Per Pronesine Industriale" ben fjale per procedurat per rregjistrim te markes dhe kete rregjistrim mund ta beje me kerkese vetem pronari I markes. Shtrohet pyetja: A eshte e rregjistruar prane Drejtorise se pronesisë Industriale malli birre e markes * nga ana e shoqerise gjermane ***? Kjo per faktin se nga fryma e ligjit te sipercituar dhe sipas neneve 162 dhe 163 të ligjit, duhet bere me pare rregjistrimi i markes pastaj rregjistrimi i licenses se shperndarjes e cila nuk eshte gje tjeter vecse nje kalim I te drejtave te pronarit te markes ne masen qe ky I fundit I jep te licensuarit. Prej ketej vihet ne pikepyetje te madhe dhe vete rregjistrimi I kontrates se licensimit.**

Le ti referohemi nenit 4 te Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Per Pronesine Industriale":

"14. "Licencim" është dhënia e licencës, nëpërmjet së cilës pronari i regjistrimit të njërës prej objekteve të pronësisë industriale (licencuesi) lejon palën tjetër (të licencuarin) të kryejë çdo akt apo veprim të përmendur, përkatësisht, në nenet 46, 47, 129 e 163 të këtij ligji.

15. "Licencë ekskluzive" është licenca që i jepet vetëm një të licencuari dhe që i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë atë, si dhe ta licencojë atë te persona të tjerë.

16. "Licencë joekskluzive" është licenca që nuk i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë ose ta licencojë atë te persona të tjerë."

Pra sic dhe del qarte edhe nepermjet interpretimit gjuhesor "Licencim" është dhënia e licencës, nëpërmjet së cilës pronari i regjistrimit të njërës prej objekteve të pronësisë industriale (licencuesi) lejon palën tjetër (të licencuarin) të kryejë çdo akt apo veprim të përmendur, përkatësisht, në nenet 46, 47, 129 e 163 të këtij ligji. Ne nuk na rezulton qe

shoqeria gjermane te kete rregjistruar marken e saj ne Drejtorine e Pergjithshme per Pronesine Industriale dhe per pasoje dhe rregjistrimi i marreveshjes se licensimit eshte i pavlefshem. Gjithashtu "Licencë ekskluzive" është licenca që i jepet vetëm një të licencuari dhe që i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë atë, si dhe ta licencojë atë te persona të tjerë.

Ne rastin tone shoqeria gjermane ka dijeni te plote per blerjen nga ana jone te birres *** prej kompanise holandeze dhe nuk ka bere asnje perpjekje te ndaloje shoqerine holandeze te na shese ne. Ne mbeshtetje te pretendimeve tona eshte edhe parashikimi i nenit 158 te Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Per Pronesine Industriale" qe sanksionon se: "Pronari i një marke nuk gëzon të drejtat e parashikuara në nenin 156 të këtij ligji për mallrat, që janë hedhur në treg nga ai vetë ose me pëlqimin e tij, në Republikën e Shqipërisë, ose në cilindo territor tjetër, të caktuar me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe". Sic u theksua me lart shoqeria gjermane eshte ne dijeni te plote qe ne furnizohemi nga nje klient I saj, e per pasoje, ka hequr dore nga kontrata e licensimit (te pretenduar nga paditesi pasi nuk e njohim ate) me palen paditese.

Ne kerkesepadi me qellim per te ngaterruar gjykatën pala paditese I referohet neneve 83, 87 dhe 89 te Ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 "Për pronësinë industriale" ligj ky I shfuqizar me hyrjen ne fuqi te Ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Per Pronesine Industriale", gje qe tregon se pala paditese perpiqet te gjeje argumente ligjore dhe ne ligje te vdekura qe nuk kane asnje fuqi juridike.

Pra del qarte qe pala paditese nuk ka legjitimitet aktiv ne ngritjen e kesaj padie duke gene te pabazuara keshtu edhe pikat e tjera te padise. Përfundimisht i kerkojme gjykates rrezimin e kerkesepadise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

VLERËSIMI I GJYKATËS

Gjykata vëren se paditësi ka paraqitur një padi me objekt pushimin e cënimit të të drejtave të tij të pronësisë industriale si dhe ndalimin e të paditurit që të tregëtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë produktin "birrë" të markës tregtare "****". Sa i përket shkakut ligjor, nga analiza në tërësi e padisë, rezulton se paditësi e mbështet të drejtën e tij subjektive kryesisht në dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar. Ndërsa si fakt të paligjshëm që i kundërvihet të drejtave të tij subjektive, paditësi përcakton veprimet e palës së paditur, e cila ka kryer procedurat doganore për importimin dhe tregëtimin në Republikën e Shqipërisë të një sasive prej 7260 litra birrë, të markës "****". Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se jemi përpara një padie me natyrë civile që gjen mbështetje në të drejtën e pronësisë industriale.

Përpara se të shprehet në lidhje me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të padisë, gjykata çmon të rëndësishme të evidentojë shkurtimisht disa elementë të rëndësishëm që lidhen me të drejtat e pronësisë industriale në përgjithësi dhe me markat tregtare në

veçanti.

Të drejtat e pronësisë industriale rregullohen në mënyrë të posacme nga ligji nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji për Pronësinë Industriale”), ligj i cili ka për objekt rregullimin e sistemit të dhënies dhe të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Pronësia industriale, si institut i së drejtës, ka si objekt të saj, ndër të tjera edhe markat tregtare, të cilat gjejnë rregullim të posacëm në pjesën IV të ligjit “Për pronësinë industriale”, nenet 140 e vijues të tij. Në Republikën e Shqipërisë markat tregtare regjistrohen në regjistrin e markave në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim “DPPI”). Pas regjistrimit, marka tregtare gëzon mbrojtje ligjore. Një markë e regjistruar mund të gëzojë mbrojtje në nivel kombëtar ose nivel ndërkombëtar, në varësi të faktit se si është regjistruar ajo. Pronari i një marke të regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me parashikimet ligjore. Po ashtu, pronari ka të drejtë të ndalojë personat e tretë, që gjatë veprimtarisë së tyre tregtare të çenojnë të drejtat e tij të lidhura me markën e regjistruar prej tij.

Kështu, në pikën 2 të nenit 156 të ligjit “Për pronësinë industriale” është parashikuar se: “2. Pronari i marke’s së regjistruar gëzon të drejtë n të ndalojë personat e tretë te” përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenje, që është e njëjta me marke’n, për mallra dhe she’rbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;...”. Ndërsa në pikën 3 të të njëjtës dispozitë parashikohet se: “3. Në përputhje me pike’n 2 të ke’tij neni, gjithashtu, ndalohet: a) vendosja e shenje’s te mallrat ose ambalazhet e tyre; b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur ke’të shenje, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për ke’to qëllime; c) ofrimi i she’rbimeve, duke përdorur ke’të shenje; c.) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur ke’të shenje; d) përdorimi i shenje’s në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.”.

Një nga të drejtat që gëzon pronari i një marke të regjistruar është edhe e drejta për të licencuar një subjekt tjetër. Nga përmbajtja e pikave 14 dhe 15 të nenit 4 si dhe nenit 163 të ligjit “Për pronësinë industriale”, rezulton se licencimi është dhënia e licencës, nëpërmjet së cilës pronari i markës së regjistruar, i quajtur licencuesi lejon palën tjetër, të licencuarin, të kryejë çdo akt apo veprim që lidhet me ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga marka e regjistruar. Kontrata e Licencës mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive.

Si pronari i markës së regjistruar, ashtu edhe i licensuari, kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara në ligj, mund të ngrenë padi në Gjykatë për të mbrojtur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për Pronësinë Industriale”. Ky përfundim rrjedh nga përmbajtja e nenit 184/a të ligjit “Për pronësinë industriale”, në të cilin parashikohet se: “E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas ke’tij ligji, i përket: a) pronarit të një patente, disenjoje ose marke të regjistruar; b) përdoruesit të autorizuar të një marke kolektive ose treguesi gjeografik; c)

mbajte"sit te" nje" licence ekskluzive pe"r nje" patente" ose aplikimi pe"r patente", ne" pe"rputhje me kreun XXX, si dhe mbajte"sit te" nje" licence pe"r nje" disenjo industriale ose marke, ne" pe"rputhje me nenet 129 dhe 163, te" ke"tij ligji."

Duke u kthyer ne" ceshtjen konkrete, Gjykata varen se padia eshte paraqitur nga shoqeria "****, ne" cilesine e mbajtësit te licencës për markën tregtare "****". Padiësi është licencuar ekskluzivisht dhe kontrata e licencës është regjistruar në regjistrin e markave në DPPI. Nga përmbajtja e Njoftimit për Regjistrim të Kontratës së Licencës me Nr. *** prot., datë *** (që ndryshon Njoftimin e datës ***), rezulton se kontrata e licencës i referohet markës me emërtimin "****" me nr. regjistrimi ndërkombëtar ***, me Licensues shoqëria *** dhe të Licensuar ekskluziv shoqërinë ***. Kontrata e Licencës është ekskluzive dhe pa afat dhe është dhënë "Për të gjitha mallrat dhe shërbimet e regjistruara për klasat 32 dhe 42 sipas Klasifikimit të Nicës".

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në kushtet kur padiësi gëzon cilësinë si i licencuar, ai në përputhje me nenin 184/a të ligjit "Për pronësinë industriale" gëzon legjitimitet aktiv për të ngritur padi për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale. Një përfundim është jo vetëm rrjedhojë e interpretimit të ligjit material, por gjithashtu rezulton edhe nga përmbajtja e Njoftimit për Regjistrim të Kontratës së Licencës me Nr. *** prot., datë ***, ku në seksionin me nr (793), "Të dhëna mbi kushtet e kontratës", janë pasqyruar kushtet kryesore për të cilat palët kontraktore Licensues dhe i Licensuar kanë rënë dakord. Një nga këto kushte lidhet me të drejtën e të licensuarit që të bëjë të gjitha përpjekjet për mbrojtjen e markës "****" në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga ana tjetër, Gjykata cmon se rezulton e provuar se i padituri shoqëria *** ka importuar në territorin e Republikës së Shqipërisë sasinë prej 7260 litra birrë "****", me qëllimin për të tregëtuar këtë sasi në tregun vendas. Këto veprime të palës së paditur janë kryer pa patur autorizim nga i licensuari shoqëria ***. Veprime të tilla cënojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e pronësisë industriale të mbajtësit të licensës. Shoqëria *** ka importuar mallra që përmbajnë markën tregtare "****" dhe i ka hedhur në treg këto mallra, duke vepruar në shkelje flagrante të nenit 156, pika 3, gërma "b" dhe "ç". Gjykata risjell në vëmendje se sipas kësaj dispozite "3... ndalohet: ...b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur ke"te" shenje", ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për ke"to qe"llime;c,) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur ke"te" shenje"; ...". Gjatë gjykimit nuk rezultoi që shoqëria *** të ketë ndonjë autorizim nga Licensuesi apo i Licensuari për të importuar dhe tregëtuar produktin/mallin "birrë" të markës "****". Përkundrazi, rezultoi e provuar se pas veprimeve administrative të kryer nga Dega e Doganës Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, padiësi, në cilësinë e të licensuarit ka shprehur qartësisht qëndrimin e tij për shkatërrimin e produkteve të bllokuara nga autoritetet doganore, pasi importimi dhe tregëtimi i tyre cënon haptazi të drejtat e pronësisë industriale të të licensuarit.

Në kushtet kur provohet se i padituri ka importuar mallin, birrë "****" dhe e ka hedhur atë në tregun vendas pa autorizimin e paditësit, në kundërshtim me ligjin, atëherë paditësi legjitimohet për të kërkuar detyrimin e palës së paditur që të pushojë cënimin e të drejtave të tij të pronësisë industriale lidhur me importimin dhe tregtimin e birrës "****" në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për të mos e përsëritur këtë cënim në të ardhmen. Po ashtu paditësi legjitimohet për të kërkuar gjyqësisht detyrimin e të paditurit që të ndalojë tregtimin e birrës "****" në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa autorizimin e të licensuarit. Një e drejtë e tillë rezulton nga interpretimi sistematik i nenit 156, pika 2 dhe 3 dhe nenit 163 të ligjit "Për pronësinë industriale". Nga ky interpretim rezulton se i licensuari, ashtu si edhe licensuesi – pronari i marke's se regjistruar, gëzon të drejtë'n të ndalojë personat e tretë te përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenje, që është e njëjta me marke'n, për mallra dhe shërbime, që janë te njëjta me ato, për te cilat është regjistruar marka.

Sakaq, edhe i padituri gëzon legjitimitet pasiv për t'u thirrur si i paditur në padinë objekt gjykimi, pasi është pikërisht ai që në kundërshtim me ligjin dhe pa autorizimin e të licensuarit, ka importuar nga vendi i origjinës – Hollanda, 7260 litra birrë të markës tregtare "****". Padia për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale ngrihet pikërisht ndaj cënuesit të së drejtës, dhe cënuesi i të drejtave të pronësisë industriale të palës paditëse është i padituri "****". Këto fakte rezultojnë të provuara me prova shkresore akte zyrtare, të cilat përbëjnë provë të plotë. Fakti i importimit dhe hedhjes në treg të produktit/mallit "birrë" të markës "****" nga shoqëria *** pohohet edhe nga vetë pala e paditur.

Mirëpo, duke qenë se kjo palë e konsideron jo të paligjshëm veprimin e saj për importimin dhe tregëtimin e mallrave të një marke të regjistruar dhe për të cilën, në territorin e Republikës së Shqipërisë ka një kontratë licence ekskluzive dhe pa afat, Gjykata gjen me vend të ndalet edhe në trajtimin e prapësimeve të palës së paditur, të cilat në thelb synojnë të argumentojnë ligjshmërinë e veprimeve të palës së paditur.

Gjykata vëren se prapësimi kryesor i palës së paditur lidhet me faktin se kjo palë pretendon që regjistrimi i kontratës së licencës është bërë në kundërshtim me ligjin, dhe për rrjedhojë edhe Njoftimi për Regjistrim të Kontratës së Licencës me Nr. *** prot., datë *** i DPPI, edhe akti i miratimit të aplikimit - shkresa nr. *** prot., datë *** e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë veprime administrative të paligjshme. Lidhur me këtë prapësim, Gjykata konstaton se paditësi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë kërkesëpadi, ku ndër të tjera ka kundërshtuar edhe aktet/veprimet administrative të sipërpërmendura. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. ***, datë ***, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë padisë administrative si të pambështetur në ligj dhe në prova. Heqjen e masës së sigurimit të padisë, të urdhëruar, sipas vendimit të ndërmjetëm datë *** të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë, në zbatim të nenit 40 të ligjit me Nr.49/2012, i ndryshuar.", vendim i cili ka marrë formë të prerë si i paankimuar më datë ***. Në

këto kushte, për sa kohë që prapësimi i paditësit ka gjetur zgjidhje dhe është rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës kompetente, Gjykata a quo arrin në përfundimin se ky prapësim nuk gjen mbështetje ligjore.

I pambështetur në ligj është edhe prapësimi tjetër i palës së paditur, se Kontrata midis shoqërisë gjermane dhe Shoqërisë *** ne thelb është nje kontrate furnizimi dhe nuk ka efekt për ne si palë e paditur. Kjo kontrate detyron vetëm palët e saj. Gjykata vlerëson se kontrata e lidhur midis shoqërisë gjermane, pra Licensuesit dhe shoqërisë shqiptare, të Licensuarit, mbart, ndër të tjera, karakteristikat e një kontrate licence dhe i është nënshtruar vendimmarrjes së organit kompetent administrativ, personit të tretë DPPI, i cili e ka regjistruar atë si Kontratë Licence në regjistrin e markave. Vendimmarrja e DPPI i është nënshtruar gjithashtu gjykimit administrativ dhe është gjetur e ligjshme prej gjykatës kompetente. Në këto kushte, duke qenë përpara një kontrate licence me natyrë ekskluzive, arrihet në përfundimin se kjo kontratë përbën titullin nga i cili paditësit i lind e drejta për të kërkuar nga cdo person i tretë mospërdorimin e mallrave të markës së regjistruar "****". Thënë ndryshe, vërtetë kontrata e licencës është e lidhur vetëm midis palëve Licensues dhe i Licensuar, dhe për rrjedhojë ka forcën e ligjit vetëm midis këtyre palëve, porse nga ana tjetër, është pikërisht kjo kontratë e regjistruar rregullisht në regjistrin e markave pranë DPPI, që i jep paditësit të drejtën subjektive që të kërkojë nga cdo subjekt tjetër të mos e cënojnë në të drejtën e tij ekskluzive për të përdorur, importuar dhe tregëtuar mallrat e markës "****", që sipas Klasifikimit të Nicës i përkasin klasave 32 dhe 42, mallra dhe shërbime.

Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe prapësimet e tjera të palës së paditur nuk qëndrojnë. I tillë është prapësimi se pala paditëse kërkon të sundojë tregun e vetme cka perben dhe nje shkelje te ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", pasi ky ligj, në nenin 4 të tij, i konsideron të paligjshme marrëveshjet që synojnë të pengojnë konkurrencën në treg. Gjykata vlerëson se ky parashikim ligjor nuk gjen zbatim në çështjen konkrete, pasi kontrata e licencës që përbën titullin e paditësit, nuk vendos ekskluzivitetin për tregëtimin e birrës, porse jep ekskluzivitetin vetëm për të drejtat e markës "****", që përbën vetëm një nga shumë marka të tjera të të njëjtës klasë, dhe që mund të tregtohen lirisht në tregun vendas. Sakaq, edhe prapësimet e tjera, për mungesë të legjitimitetit aktiv e pasiv, nuk qëndrojnë. Kjo Gjykatë, ka argumentuar gjerësisht në paragrafët 15-19 të këtij vendimi, ekzistencën e legjitimitetit aktiv të paditësit dhe pasiv të palës së paditur.

Duke përmbledhur analizën e mësipërme, Gjykata përfundimisht vlerëson se paditësi shoqëria *** gëzon legjitimitet aktiv për të kërkuar gjyqësisht mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe që rrjedhin nga cilësia e paditësit si i Licensuar për markën ndërkombëtare të regjistruar me emrin "****". Nga ana tjetër, është pikërisht pala e paditur, që me veprimet e saj, ka cënuar të drejtat e pronësisë industriale të palës paditëse, fakt cënuës ky që u provua në gjykim nëpërmjet të gjithë akteve zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Sa më sipër, në analizë të fundit, Gjykata konkludon se padia e paditësit shoqëria *** është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe për rrjedhojë ajo duhet të pranohet duke u detyruar pala e paditur ***, që të pushojë cenimin e të drejtave të pronësisë industriale ndaj palës paditëse lidhur me tregëtimin e produktit birrë "****" dhe të mos e përsërisë në të ardhmen. Po ashtu, Gjykata cmon se duhet pranuar edhe kërkimi tjetër i palës paditëse për ndalimin e palës së paditur të tregëtojnë në territorin shqiptar produktin birrë që mban logon "****", mallra dhe shërbime të regjistruara për klasat 32 dhe 42 sipas klasifikimit të Nicës, pa autorizimin e palës paditëse ***, si distributor ekskluziv i këtij produkti.

SHPENZIMET GJYQËSORE

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, Gjykata sjell në vëmendje nenin 106/1 të K.Pr.Civile, në të cilin është përcaktuar se: “Tarifa, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata.”. Duke qënë se Gjykata ka arritur në përfundimin se padia duhet pranuar, atëherë shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur shoqërisë ***.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenet 106, 126, 306 deri 310 të Kodit të Proçedurës Civile

V E N D O S I:

Pranimin e padisë.

Detyrimin e palës së paditur Shoqërisë *, që të pushojë cenimin e të drejtave të pronësisë industriale ndaj palës paditëse Shoqërisë ***, lidhur me tregëtimin e produktit birrë "****" për shkak të të drejtave që i burojnë paditësit nga kontrata ekskluzive e licencës regjistruar me vendimin dt. *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe të mos e përsërisë në të ardhmen.**

Ndalimin e palës së paditur të tregëtojnë në territorin shqiptar produktin birrë që mban logon "**", mallra dhe shërbime të regjistruara për klasat 32 dhe 42 sipas klasifikimit të Nicës, pa autorizimin e palës paditëse ***, si distributor ekskluziv i këtij produkti.**

Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim palës së paditur.

Kundër vendimit mund të paraqitet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë Brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, më datë 21.07.2021.

**SEKRETARE
GENCJANA DADA**

**GJYQTARE
ALMA KODRALIU**

Nr	Shpenzime gjyqesore	Pala qe ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqesor			Sasi	Cmim	Vlere
		Gjykata	Padites	I Paditur			
1	Tarife Gjyqesore	-	+	-	1	3000	3000
2	Shpenzime per njoftime	-	+	-	4	150	600
3	Shpenzime per njoftime	+	-	-	4	150	600
	Shuma						4200